

VENDIM
Nr. 272, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.651, DATË 14.9.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10139, DATË 15.5.2009, “PËR PENSIONET
SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË UNIVERSITETEVE, TË
SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË
SHKENCAVE DHE TË GJITHA INSTITUCIONEVE TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË CILËT KANË TITUJ SHKENCORË”, TË
NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 12 e 15, të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar”, dhe ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 7, e vendimit nr.651, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Personat e interesuar për të përfituar pension suplementar sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar, paraqesin, nëpërmjet portalit qeveritar “*e-Albania*”, kërkesën për përfitim dhe dërgojnë, nëpërmjet shërbimit postar, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku kanë vendbanimin, dokumentet shoqëruese, si më poshtë vijon:

a) Fotokopje të noterizuar të dëshmisë për dhënien e titullit ose vërtetim për dhënie titulli nga komisioni i kualifikimit shkencor apo nga komisioni i vlerësimit të titujve;

b) Vërtetim, lëshuar nga qendra e punës, për pagën referuese, si dhe kohën e gëzimit të titullit, në zbatim të ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, të ndryshuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj